



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës, 20/03/2024

MIRATOI

ZËVENDËSKRYETAR

Elio Jani

DETYRË PROJEKTIMI



**OBJEKTI “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH”**

Bashkia Durrës , me fond 20 000 000 lekë me tvsh të miratuar në Këshillin Bashkiak në buxhetin e vitit 2024 kërkon të realizojë projekt-zbatimin për objektin:

**“RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH”.**

Fragmentet e rrugëve të cilat do të inenvstohet do të jetë sipas gjurmës së mëposhtme:



Investimi do të përfshijë një kuartall në Sukth si dhe sistemimin e një trotuari.  
Këto rrugë do të kenë një gjerësi të asfaltit në bazë të standarteve të projektimit dhe me trotuar nëse është mundësia

## 2. Kërkesa të veçanta

- Nuk ka kërkesë specifike dhe nuk do të ketë devijime të mëdha , do të ruhen kërkesat specifike për kufinj të e lejuar të pjerrësisë së rrugës.
- Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës. Në pika të vecanta duhet të përcaktohen vënde për shkëmbim mjetesh.
- Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.
- Projektuesi përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht të bëjë relievin (azhornimin) ;
- Projektuesi duhet të paraqesë mënyrat e aksesit dhe të qarkullimit në rrugë dhe lidhjet me rrjetin ekzistues rrugor të zonës.
- Të realizojë kullimin e ujrave të shiut ku është e nevojshme dhe e mundur.

## 3.Hartimi I Preventivit

Në hartimin e preventivit, do të mbahet parasysh organizmi i zbatimit me faza të projektit, çmimet e përdorura duhet të jenë sipas manualit teknik në fuqi dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe eficientë e përdorimit të fondeve.

## 4. Standartet

- Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi.Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit.Eshtë përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.
- Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

## 5.Projekti i Zbatimit duhet të përmbajë

1. Hartimi i relievit topografik (kordinata lokale, kuota absolute)
2. Profilat tip të seksionit tërthor
3. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave etj (nëse ka)
4. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut (nëse ka)
5. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal. (nëse ka)
6. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- 7.Preventivi
8. Grafiku i punimeve.

#### 6. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje) në shkallë. 1:250, 1:500 ose 1:1000
2. Planimetria e sistemimit të rrugëve ose shesheve në shkallë. 1:250, 1:500 ose 1:1000
3. Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, trotuareve, pusetave, etj.

Konceptoi: L.Facja

